

ANEKSI 5

Kriteret e Kualifikimit dhe Pranueshmërisë

1. Emri dhe adresa e kompanisë / Numri i regjistrimit në Regjistrin Tregtar
 2. Kompania është e regjistruar ligjërisht dhe e autorizuar për të ushtruar aktivitetin profesional të nevojshëm për realizimin e punës që është objekt i kësaj kërkesë për ofertë. Ju lutemi, paraqisni një ekstrakt nga QKB-ja.
 3. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 4 600 000 lekë.
 4. Certifikatë/Konfirmim për pagesën e detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 5. Certifikatë/Konfirmim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 6. Certifikatë që konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike të maturuara;
 7. Numri i punonjësve – Ju lutemi paraqisni një dokument zyrtar që vërteton numrin e punonjësve për vitet e sipërpërmendura, duke dëshmuar se të paktën 3 (tre) punonjës të përhershëm kanë qenë të regjistruar në secilin prej tre viteve të fundit (mesatarja për vitin 2023, mesatarja për vitin 2024 dhe mesatarja për vitin 2025. Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.
 8. Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (të përkthyer dhe noterizuar).
 9. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi kjo e vërtetuar nëpërmjet dokumentave orgjinal si përfaqesues i kompanisë prodhuese për mallin/mallrat. Në rast paraqitje Autorizimi Distributori, OE duhet të paraqesë në letër angazhim ose Akt marreveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre, mbi të drejtat e furnizimit me llojin e mjetit të ofruar në Republikën e Shqipërisë.
Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon/fax/e-mail/ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
- Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun ose fragmente të katalogut të prodhuesitë për listën e mallit objekt prokurimi, në të cilën të tregohet dhe të specifikohet qartë materiali që do të ofrohet.
- Shënim:** Fragmentet e katalogut duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

- 10.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë konformiteti europiane (të lëshuar nga prodhuesi) që vërteton të dhënat teknike, standartin e prodhimit sipas kërkesave mbi standartin të përcaktuar në specifikimet teknike.
- 11.** Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë, servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjetit gjatë periudhës së garancisë.
- për ambjentet të cilat janë në pronësi, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton pronësinë.
 - Për ambjentet me qera, Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e qerasë të shoqëruar me dokumentin që vërteton pronësinë e qeradhënësit.
- 12.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë të garancisë për mallrat e ofertuara, në të cilën të jenë të përcaktuara dhe përshkruara qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike të fabrikimit që mbulon ofertuesi, si dhe periudha e garancisë teknike jo me pak se 3 vjet ose 100,000 km.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nepermjet te ciles te deklaroje se merr persiper levrimin e plote te mallrave objekt prokurimi brenda 4 (kater) muaj nga dita e lidhjes së kontratës.

13. Kushte të tjera të detyrueshme :

- Automjeti te dorëzohet pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile i zhdoganuar, me detyrimet e shlyera në Organet Tatimore.
- Në çmim janë përfshirë të gjitha shpenzimet doganore, regjistrimi, targat, siguracion dhe kolaudim; shërbimet teknike të planifikuara të kryhen pa pagesë për vitin e parë (kohë e nevojshme për lidhjen e kontratave të shërbimeve mirëmbajtëse).
- Automjeti duhet të përmbushë normat dhe standardet e CE

14. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 4 600 000 lekë.

Titulli i projektit dhe klienti	Fusha/fokusi i detyrave	Rajoni	Periudha	Vlera e kontratës në LEK

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, kontraten midis paleve ku të shënohet preventivi dhe vlera dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

15. Deklaratë / Ofertuesi konfirmon:

- Përputhshmërinë me specifikimet teknike
- Dorëzimin Brenda 4 (kater) muajve nga data e lidhjes së kontratës.
- Mbështetje të vazhdueshme gjatë zbatimit të garancisë.

16. Emri i anëtarit kryesor të stafit përgjegjës për mbështetjen e projektit të mësipërm në selinë e kompanisë suaj;

17. Personi i kontaktit për pyetje

emri:

email:

telefoni: